



Akti Normativ nr. 8, datë 24.03.2020

Në fletoren zyrtare 48, u publikua Akti Normativ nr. 8, datë 24.03.2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime ne Aktin Normativ nr. 3, date 15.03. 2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” (“Akti Normativ 8”)*.

Akti Normativ 8 parashikon shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme ne Aktin Normativ nr. 3, date 15.03.2020:

1. Përveç strukturave private spitalore, ambulatorie dhe hoteliere, me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe të ministrit përgjegjës për rindërtimin, çdo strukturë/objekt tjetër që konsiderohet i domosdoshëm, vendoset në dispozicion për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19.
2. Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për kufizimin e lëvizjes vetëm në fasha orare të caktuara dhe të pashoqëruar me persona të tjerë në krah, dënohen me gjobë 10.000 lekë, si dhe me mos-përfitimin nga paketa financiare e solidaritetit dhe bllokim 3 (tre) muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.
3. Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte ushqimore dhe produkte të tjera, me shumicë, të domosdoshme për përballimin e situatës së epidemisë, janë të detyruar të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19. Mallrat e blerë, me qëllim përballimin e situatës, në rast kur me përfundimin e situatës së epidemisë nuk janë shitur në tregun e lirë, me kërkesë të subjektit, mund t'i shiten Drejtorisë sëPërgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas faturës me të cilën këto mallra janë blerë.
4. Të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë barna/pajisje mjekësore, subjekte që prodhojnë barna dhe pajisje mjekësore dhe subjektet që ofrojnë shërbime shëndetësore, të jenë në gatishmëri dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar furnizime me barna dhe pajisje mjekësore dhe për të ofruar shërbime shëndetësore të nevojshme, në kuadër të përballimit të situatës së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19.
5. Mos-marrja e masave, sipas përcaktimeve të përshkruara në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, dënohet me gjobë në masën 5.000.000 lekë dhe me përjashtimin nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare.
6. Ky Akt Normativ hyn në fuqi menjëherë.



Normative Act no. 8, dated 24.03.2020

On the Official Gazette no. 48, is published the Normative Act of the Council of Ministers no. 8, dated 24.03.2020 *"On some additions and amendments on the Normative Act no. 3, dated 15.03.2020 "On special administrative measures during the infection period caused by COVID-19" ("Normative Act 8")*.

The Normative Act 8, provides for the following additions and amendments in the Normative Act no. 3, dated 15.03.2020:

1. Apart from hospitals, health and hotel structures, upon proposal of the Minister of Health and the Minister for Reconstruction any other structure considered indispensable is placed at the disposal of the emergency situation caused from COVID-19.
2. Individuals who do not comply with circulation limitations in the daily hours set from the authorities and without accompanying persons may be subject to a penalty of ALL 10.000, exclusion from the benefits deriving from alleviating financial measures related to the emergency and the seizure of the auto-vehicle (if any) for a period of 3 months.
3. All entities engaged in the wholesale of food and other products indispensable for the situation of the epidemic emergency caused from COVID 19, should take the necessary actions for assuring a trading stock of 3 months or in accordance with the expiration terms of the products. In case that the epidemic emergency ends, and the wholesale traders have not sold the stock accumulated under this provision, upon their request may sell the remaining stock to the General Directorate of State Reserves in accordance with the purchase invoice of the goods.
4. All entities engaged in the wholesale and production of medicines/medical devices and entities that provide health services, should be prepared and should undertake all measures needed to secure the supplies of medicinals and medical devices and to provide necessary health services, in order to tackle the situation of the epidemic emergency situation caused by COVID-19.
5. Failure to comply with the obligations described in points 3 and 4 above may be subject to a penalty of ALL 5.000.000 and the expulsion for 3 years from procedures of public procurement.
6. This Normative Act enters into force immediately.